



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 164

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA PËR MBROJTJEN
E TË DREJTAVE TË EMIGRANTËVE”, ME KRYETAR Z. YMER KURTI, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1240 Prot., datë 24.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me kryetar Z. Ymer Kurti

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025

Baza ligjore: Neni 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Ymer Kurti, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 19.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia

Data: 25.2.2025 Nr: 164
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me Kryetar Z. Ymer Kurti, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

- për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me initiale “P.M.D.E”, me Kryetar Z. Ymer Kurti, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
 - c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me shkronja nistore “P.M.D.E”, me adresë: Rruga "Z.Curre", Lagjia "Ali Demi", Shk 1 , Ap. 18, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Ymer Kurti, me adresë: Rruga "Z. Curre", Shk 1, Ap. 18, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Fidane Grosha, me adresë: Rruga "Z.Curre", Lagjia "Ali Demi", Shk 1 , Ap. 18, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ymer Kurti, me adresë: Rruga "Z.Curre", Lagjia "Ali Demi", Shk 1 , Ap. 18, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025”.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me kryetar Z. Ymer Kurti, me shkronjat nistore “P.M.D.E”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI